Sistemi i pikëzimit sipas Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", te nenit 5, miratohet me vendim të këshillit bashkiak për çdo program të strehimit social që zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe publikohet sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore.

Për sa arsyetuam më lartë, shpresojmë në votimin e projekt-vendimit *"Për përzgjedhjen e përfituesve nga programi i strehimit social përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara"*

Znj. Serielda Mejdani

Administrator shoqëror , Drejtoria e Kujdesit Social

Znj. Garufo Koka

Drejtor , Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli

Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr.105 datë 30.09.2026

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENSIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE NGA SHTETI "

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar, nenet 15, 16, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm", Vendimi Nr 3 datë 16.09.2026, të Komisionit të Strehimit ,me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social , Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvencionimi i interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

K R Y E T A R
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SARANDË

Tabela 1

FORMATI TIP I SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN BANESË ME KOSTO TË ULËT (SUBVENSIONIMIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE)

	Kriteret e Pikëzimit	Pikët
1,1	***Kushtet e strehimit***	**25**
A	Nuk disponon banesë në pronësi	10
B	Banojnë në banesa rrezik shembjeje	7
C	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i zbatimit të një vendimi gjyqësor	3
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
1,2	***Kushtet familjare***	**25**
A	Familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna	6
B	Të moshuar që kanë mbushur moshë e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucion publik të përkujdesjes shoqërore	1
C	Familjet me më shumë se 4 fëmijë	8
Ç	Familje e re ku mosha e anëtarit më të madh të të cilës në momentin e paraqitjes së kërkesës është më e vogël ose baras me 40 vjeç	5
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	5
1,3	***Kushtet sociale***	**25**
A	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	**5**
B	Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara	5
C	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	2
Ç	Emigrant i rikthyer, punëtor migrant dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese	2
D	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	2
E	Vajza-nëna	2
F	Viktimë e dhunës në familje	4
G	Anërat i minoritetit Rom	2
H	Anëtar i minoritetit Egjiptian	1
1,4	***Kushtet ekonomike***	**25**
A	Familje pa të ardhura	3
B	Familje me të ardhura shumë të ulta	5
C	Familje me të ardhura të ulta	7
Ç	Familje me të ardhura mesatare	10

Administrator Shoqëror
Serielda Mejdani

Kryetar komisioni
Anila Pikuli

RELACION PËR PROJEKT - VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENSIONIMI I INTERESAVE TË KREDISË ME KUSHTE LEHTËSUESE"

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Sarandë në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar, nenet 15, 16, dhe në vijim pas miratimit nga ana juaj për ngritjen e komisionit të strehimit, paraqet përpara jush këtë projekt vendim për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvensionimi i interesave të kredisë me kushte lehtësuese"

Programi social i strehimit për "Subvencionimin e interesave të kredisë" synon të mbështesë individë /familje në blerjen e shtëpive të para, me qëllim përmirësimin e cilësisë të jetesës.Prioritet i jepet çifteve të reja, individë me moshë jo më shumë se 40 vjet, gra kryefamiljare apo individë /familje të minoritetit rom e egjiptian. Kategoritë e cilësuara më lart përbëjnë përparësi por nuk përjashtojnë kategoritë e tjera prioritare që përcakton neni 16 i ligjit nr.22/2018 "Për strehimin social".

Subvencionimi i interesave të kredisë, është instrument financiar që siguron strehim social në kushtet e banesave me kosto të ulët kur këto të fundit janë në mungesë. Kushtet e dhënies së kredisë bazohen në Marrëveshjen Dypalëshe "Për Kreditimin në Kuadër të Programit të Banesave me Kosto të Ulët për Familjet që Përfitojnë Subvencionimin e Interesave të Kredisë" nenshkruar midis palëve, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me bankat e nivelit të dytë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit me bankat e nivelit të dytë Raiffeisen, Banka Kombëtare Tregtare dhe Intesa San Paolo dhe familjet përfitojnë kredi me interes jo më të lartë se 3 % dhe me afat maksimal 30 vjet. Diferenca midis interesit të kredisë hipotekore dhe interesit 3% të kredisë së lehtësuar mbështetet me fonde nga buxheti i shtetit.

Duke u mbështetur në Ligjin Nr 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", Ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 8 pika 2 dhe neni 9 pika 1.1 b dhe neni 24 pika 2 , si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të proçedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore" dhe VKM Nr. 453 datë 03.07.2019 " Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe proceduren e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga shteti", i ndryshuar me VKM Nr. 268 datë 29.04.2022, me Vendim të Komisionit të Strehimit Nr.3 datë 16.09.2026 i paraqesim Këshillit të Bashkisë Sarandë, sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga zbatimi i instrumentit financiar për strehimin social, subvencionimi i interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti, sistem i cili nuk ka ndryshime thelbësore përsa i përket pikëve për çdo kategori, por ka vetëm saktësime në terminologjinë e përdorur me qëllim që të përputhet me terminologjinë e përdorur në formatin e aplikimit në sistemin online të strehimit, tabela bashkangjitur.

Sistemi i pikëzimit sipas Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", te nenit 5, miratohet me vendim të këshillit bashkiak për çdo program të strehimit social që zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe publikohet sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore.

Për sa arsyetuam më lartë, shpresojmë në votimin e projekt-vendimit *"Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvensionimi i interesave të kredisë me kushte lehtësuese nga shteti "*

Znj. Serielda Mejdani

Administrator shoqëror , Drejtoria e Kujdesit Social

Garufo Koka

Drejtor, Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli

Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM

Nr. 106 datë 30.09.2026

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREGUN E LIRË SI DHE MBI NORMAT E STREHIMIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT"

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar, nenet 15, 16, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.384 datë 12.06.2019 "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", Vendimi i Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.153 datë 23.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 dhe programin buxhetor afatmesëm", Vendimi Nr 3 datë 16.09.2026, të Komisionit të Strehimit ,me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social ,me propozim të Drejtorisë së Kujdesit Social , Këshilli i Bashkisë Sarandë,

VENDOSI:

1. Të miratojë sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvencionimi i qirasë në tregun e lirë si dhe mbi normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit, sipas tabelës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

K R Y E T A R
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

Tabela 1

FORMATI TIP I SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PROGRAMIN E BANESAVE SOCIALE ME QERA (SUBVENSIONIMIT TË QIRASË NË TREGUN E LIRË)

	Kriteret e Pikëzimit	Pikët
1,1	***Kushtet e strehimit***	**25**
A	Nuk disponon banesë në pronësi	9
B	Banojnë në banesa rrezik shembjeje	5
C	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i zbatimit të një vendimi gjyqësor	6
Ç	Kanë ngelur ose rrezikojnë të ngelen të pastreha si rezultat i fatkeqësive natyrore	5
1,2	***Kushtet familjare***	**25**
A	Familjet një prindërore që kanë në ngarkim fëmijë. ku përfshihen edhe vajzat nëna	8
B	Të moshuar që kanë mbushur moshë e pensionit dhe që nuk përzgjidhen për tu strehuar në institucion publik të përkujdesjes shoqërore	5
C	Familjet me më shumë se 4 fëmijë	7
Ç	Familje e re ku mosha e anëtarit më të madh të të cilës në momentin e paraqitjes së kërkesës është më e vogël ose baras me 40 vjeç	3
D	Të rinj që në momentin e paraqitjes së kërkesës kanë një moshë jo më të madhe se 40 vjeç	2
1,3	***Kushtet sociale***	**25**
A	Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike	**5**
B	Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara	5
C	Ka statusin e jetimit dhe moshë deri në 30 vjeç	2
Ç	Emigrant i rikthyer, punëtor migrant dhe refugjatët apo personat me mbrojtje plotësuese	2
D	Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë	2
E	Vajza-nëna	2
F	Viktimë e dhunës në familje	4
G	Anërat i minoritetit Rom	2
H	Anëtar i minoritetit Egjiptian	1
1,4	***Kushtet ekonomike***	**25**
A	Familje pa të ardhura	10
B	Familje me të ardhura shumë të ulta	7
C	Familje me të ardhura të ulta	5
Ç	Familje me të ardhura mesatare	3

Administrator Shoqëror
Serielda Mejdani

Kryetar komisioni
Anila Pikuli

Tabela 2

Vendim Nr. 301 datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qera që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët"

Hapësirat minimale të shfrytëzueshme në një banesë sociale që ndërtohet, blihet ose përshtatet dhe sipërfaqja neto maksimale e lejuar për llojet më të zakonshme të njësive të banimit, si dhe masa mujore e subvencionimit të qerasë që do të aplikohet sipas tipit të njësisë së banimit.

Sipërfaqet për çdo lloj banese			
Tipi i njësisë së banimit	Sipërfaqja Neto (m2)		
	Minimale	Maksimale	Masa mujore (lekë)
Studio	30	45	13 000
1+1	40	55	16 000
2+1	50	81	22 000
3+1	60	100	27 000

Administrator Shoqëror
Serielda Mejdani

Kryetar komisioni
Anila Pikuli

Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

Annual Changes of Consumer Price Index

COICOP Version 2	Grupet	05-25	06-25	07-25	08-25	09-25	10-25	11-25	12-25	01-26	02-26	03-26	04-26	05-26	06-26	07-26	08-26	COICOP Ver. 2 Title
000000	**Gjithsej**	**2,2**	**2,4**	**2,5**	**2,3**	**2,4**	**2,3**	**2,1**	**2,3**	**2,3**	**2,5**	**2,6**	**2,8**	**3,0**	**3,2**	**3,4**	**3,2**	**Total of all items**
04.	**Qira, ujë, energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera**	**1,5**	**1,8**	**3,0**	**3,1**	**4,1**	**4,3**	**4,0**	**4,7**	**4,3**	**5,3**	**4,7**	**4,6**	**4,1**	**4,7**	**4,1**	**3,7**	**Housing, water, electricity, gas and other fuels**
04.1	Qira	3,6	4,7	5,4	5,2	6,6	6,7	6,7	8,5	8,5	8,5	7,3	7,1	6,0	5,7	5,2	4,7	Actual rental payments made for housing
04.3	Mirëmbajtja, riparimi dhe sigurimi i banesës	2,5	3,1	2,8	3,1	3,0	2,5	2,6	0,8	0,8	0,6	0,6	0,7	0,8	0,5	0,8	0,4	Maintenance, repair and security of the dwelling
04.4	Furnizim me ujë	2,8	2,8	2,8	2,8	3,4	3,6	3,6	3,6	3,6	1,7	1,7	1,7	1,7	1,7	1,7	1,7	Water supply and miscellaneous services relating to the dwelling
04.5	Energji elektrike, gaz dhe karburante të tjera	-0,8	-1,8	-2,6	-2,4	-1,5	-2,0	-2,2	-1,9	-3,5	0,5	-0,4	-0,6	-1,3	-2,1	0,6	0,6	Electricity, gas and other fuels

Burimi: INSTAT

RELACION PËR PROJEKT - VENDIMIN

"PËR MIRATIMIN E SISTEMIT TË PIKËZIMIT PËR PËRZGJEDHJEN E PËRFITUESVE NGA PROGRAMI PROGRAMI SUBVENCIONIMI I QIRASË NË TREGUN E LIRË SI DHE MBI NORMAT E STREHIMIT PËR FAMILJET QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMET SOCIALE TË STREHIMIT"

Të nderuar Këshilltarë!

Bashkia Sarandë në mbështetje të Ligjint nr. 139/2015 datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" nenin 8,pika 2, nenin 9, pika 1 dhe 1.1, shkronja "b", nenin 24, 54, në Ligjin nr. 22/2018 "Për Strehimin Social"i ndryshuar, nenet 15, 16, dhe në vijim pas miratimit nga ana juaj për ngritjen e komisionit të strehimit, paraqet përpara jush këtë projekt vendim për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvencionimi i qirasë në tregun e lirë.

Subvencionimi i qirasë ose bonusi i strehimit është një instrument financiar në funksion të programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale ne tregun e lirë. Bazuar në vlerësimin e nevojave për strehim dhe mundësitë financiare për të mbështetur me fonde këtë program që aplikojnë familjet e pastreha pa të ardhura ,me të ardhura të ulëta, shumë të ulëta nga Bashkia Sarandë realizohet në bashkëfinancim me fonde të siguruara nga buxheti i shtetit nëpërmjet MFE bazuar në kufinjtë e financimit sipas Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit".

Për aplikimet që kanë bërë qytetarët, kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social dhe që plotësojnë kushtet për "Subvencionimin e qirasë" përzgjedhja e përfituesve bëhet nëpërmjet sistemit të pikëzimit , i cili në total ka 100 pikë dhe për çdo kriter te përcaktuar në ligj, neni 15 ka 25 pikë. Në zbatim të Ligjit Nr. 22/2018, "Për Strehimin Social ", të neneve 15, 16, 3, 33, 34 dhe 38 i ndryshuar , i ndryshuar Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", VKM Nr. 384 , datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, proçedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore", VKM Nr. 362 , datë 29.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", Ligjit Nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", po ju paraqesim sistemin e pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga zbatimi i instrumentit financiar për strehimin social, subvencioni i qirasë, sistem i cili nuk ka ndryshime thelbësore përsa i përket pikëve për çdo kategori, por ka vetëm saktësime në terminologjinë e përdorur me qëllim që të përputhet me terminologjinë e përdorur në formatin e aplikimit në sistemin online të strehimit, tabela bashkangjitur.

Bazuar në VKM Nr.301, datë 15.04.2020 "Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit", si dhe VKM Nr. 469, datë 03.06.2015 "Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore", gjatë mbledhjes së Komisionit të Strehimit Nr.3 datë 16.09.2026 u aprovuan dhe masat e reja mujore të subvencionimit të qerasë që do të aplikohet sipas tipit të njësisë së banimit, për arsye se kostoja e jetesës, si dhe çmimet e qerave të apartamentet në qytetin tonë janë rritur, tabela bashkangjitur.

Sistemi i pikëzimit sipas Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", te nenit 5, miratohet me vendim të këshillit bashkiak për çdo program të strehimit social që zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe publikohet sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore.

Sistemi i pikëzimit sipas Ligji Nr. 48/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 22/2018", te nenit 5, miratohet me vendim të këshillit bashkiak për çdo program të strehimit social që zbatohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore dhe publikohet sipas ligjit të vetëqeverisjes vendore.

Për sa arsyetuam më lartë, shpresojmë në votimin e projekt-vendimit *"Për miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve nga programi subvencionimi i qirasë në tregun e lirë si dhe mbi normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimi"*

Znj. Serielda Mejdani

Administrator shoqëror , Drejtoria e Kujdesit Social

Garufo Koka

Drejtor , Drejtoria Juridike

Znj. Anila Pikuli

Drejtor, Drejtoria e Kujdesit Social

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr.107 datë 30.09.2026

"PËR MIRATIMIN E SHTESËS NË BUXHETIN E BASHKISË SARANDË PËR VITIN 2026"

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", të ndryshuar, Aktit Normativ nr. 2, datë 30.06.2026 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 87/2025 'Për buxhetin e vitit 2026'", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 151, datë 23.12.2025 "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026", Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë shtesën në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026, në shumën 2,255,795 (*dy milionë e dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e pesë*) lekë, fond i alokuar për Bashkinë Sarandë në funksion të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas shkresës nr. 429/6 prot., datë 15.04.2026, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi të reflektohet në buxhetin e vitit 2026 në:

   - Programin buxhetor 03280 – Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile (PMNZSH);
   - Llogaria ekonomike 600 – Paga;
   - në shumën 2,255,795 lekë.

3. Ky fond do të përdoret për përballimin e shpenzimeve për paga të strukturës së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, në përputhje me destinacionin e përcaktuar në aktin e alokimit të fondit dhe legjislacionin në fuqi për menaxhimin buxhetor.

4. Ngarkohen Drejtoria e Financës, struktura përgjegjëse për PMNZSH-në dhe strukturat e tjera përgjegjëse të Bashkisë Sarandë për reflektimin dhe zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

RELACION PWR
PROJEKT-VENDIM

"PËR MIRATIMIN E SHTESËS NË BUXHETIN E BASHKISË SARANDË PËR VITIN 2026"

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Buxheti i Bashkisë Sarandë për vitin 2026 është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 151, datë 23.12.2025. Gjatë zbatimit të buxhetit, në vijim të financimeve të akorduara nga buxheti i shtetit për njësitë e vetëqeverisjes vendore, është bërë i nevojshëm reflektimi në buxhetin vendor i një fondi shtesë të alokuar për Bashkinë Sarandë.

Nëpërmjet shkresës nr. 429/6 prot., datë 15.04.2026, të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Bashkisë Sarandë i është alokuar fondi në shumën 2,255,795 lekë, në funksion të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit.

Ky financim përbën një burim shtesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë dhe, për rrjedhojë, kërkon reflektimin e tij në planin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit vendor për vitin 2026, në përputhje me destinacionin për të cilin fondi është akorduar.

Konkretisht, propozohet që shuma prej 2,255,795 lekësh të shtohet në programin buxhetor 03280 – PMNZSH, në llogarinë ekonomike 600 – Paga, me qëllim përballimin e shpenzimeve për paga të strukturës së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Nevoja për miratimin e kësaj shtese buxhetore lidhet me domosdoshmërinë e reflektimit në buxhetin e Bashkisë të fondeve të akorduara gjatë vitit buxhetor dhe përdorimin e tyre në përputhje me destinacionin e përcaktuar. Përfshirja e këtij fondi në buxhet garanton njëkohësisht respektimin e parimeve të ligjshmërisë, transparencës dhe disiplinës në administrimin e fondeve publike.

Në aspektin financiar, projektvendimi sjell rritjen e buxhetit të Bashkisë Sarandë për vitin 2026 me 2,255,795 lekë, duke rritur në të njëjtën masë financimin e programit për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin. Fondi nuk krijon detyrime financiare shtesë për t'u mbuluar nga të ardhurat e veta të Bashkisë, pasi burimi i financimit është fondi i alokuar për këtë qëllim.

Miratimi i projektvendimit është gjithashtu i nevojshëm për të mundësuar pasqyrimin korrekt të fondit në sistemin buxhetor dhe financiar dhe vijimin e procedurave për përdorimin e tij sipas destinacionit të përcaktuar.

Për sa më sipër, duke qenë se fondi është alokuar në mënyrë të posaçme për funksionin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit dhe duhet të reflektohet në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i projektvendimit "Për miratimin e shtesës në buxhetin e Bashkisë Sarandë për vitin 2026", në shumën 2,255,795 lekë, sipas përcaktimeve të projektvendimit bashkëlidhur.

Znj. Teuta Stroka
Drejtor, Drejtoria e Financës

Znj. Garufo Koka
Drejtor, Drejtoria Juridike

Z. Nasibi Hasanllari
Kryeinspektor, PMNZSH

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SARANDË

PROJEKT-VENDIM
Nr. 108, datë 30.09.2026

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK SARANDË NR. 151, DATË 23.12.2025 "PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SARANDË TË PASURIVE ME NR. 395, NR. 409, NR. 432, NR. 430 DHE NR. 441, ZONA KADASTRALE 1722"

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1, nënpika 1.1, gërma "b", nënpika 1.1, shkronja "a" "c", nenin 23, pika 11, nenin 54, nenin 55, pika 2 dhe 6 të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit" të ndryshuar; ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" të ndryshuar; ligjin nr. 20, datë 5.3.2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 500, datë 14.8.2001, "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e vetëqeverisjes vendore" të ndryshuar; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 28, datë 27.1.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve"; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 782, datë 7.10.2020, "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtjen e hartës kadastrale"; udhëzimin nr. 15, datë 30.6.2003 të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimin "Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike", Vendimi i Këshillit Bashkiak Sarandë nr.142 datë 30.11.2023 "Për miratimin e planit social të strehimit të Bashkisë Sarandë 2024-2028" , Vendimi i Këshllit Bashkiak nr. 151, datë 23.12.2025,

V E N D O S I:

1. Pika 1 e Vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. 151, datë 23.12.2025, ndryshohet dhe riformulohet si më poshtë:
   "*1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurive me nr. 395, nr. 409, nr. 432, nr. 430 dhe nr. 441, Zona Kadastrale 1722, duke përcaktuar fushat e përdorimit të tyre si më poshtë:*
   a) Pasuria me nr. 441, Zona Kadastrale 1722, të transferohet në pronësi të Bashkisë Sarandë për t'u përdorur në fushën e shërbimeve publike, me funksion 'Shërbimi funeral';
   b) Pasuritë me nr. 395, nr. 409, nr. 432 dhe nr. 430, Zona Kadastrale 1722, të transferohen në pronësi të Bashkisë Sarandë për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik dhe në fushën e bujqësisë dhe ushqimit sipas formularëve dhe planeve të rilevimit bashkëlidhur, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij vendimi."
2. Pikat e tjera të Vendimit të Këshillit Bashkiak Sarandë nr. 151, datë 23.12.2025, mbeten të pandryshuara.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Projekteve, Turizmit dhe Integrimit Europian.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe pas konfirmimit ligjor nga Prefektit i Qarkut Vlorë.

KRYETAR
Oltion ÇAÇI
Me urdhër dhe delegim kompetencash
ZV/KRYETAR
Manjola NIKOLLO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË

RELACION PËR PROJEKT- VENDIMIN

"PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK SARANDË NR. 151 DATË 23.12.2025"

Të nderuar Këshilltar!

Në kuadër të ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të Bashkisë Sarandë për administrimin dhe menaxhimin e pronave publike, me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 151, datë 23.12.2025, është miratuar kërkesa për transferimin në pronësi të Bashkisë Sarandë të pasurive me nr. 395, nr. 409, nr. 432, nr. 430 dhe nr. 441, Zona Kadastrale 1722, me sipërfaqe të përgjithshme 328.534 m^2.

Në pikën 1 të vendimit të sipërcituar është përcaktuar në mënyrë të përgjithshme se pasuritë kërkohen për t'u përdorur në funksion të *fushës së infrastrukturës dhe shërbimeve publike*, pa u bërë një ndarje dhe specifikim i veçantë i fushës së përdorimit për secilën pasuri objekt transferimi.

Pas miratimit të VKB-së dhe në vijim të procedurave administrative për realizimin e transferimit të pronësisë, Bashkia Sarandë ka zhvilluar korrespondencë me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës – Drejtoria e Përgjithshme, lidhur me shqyrtimin dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për vijimin e procedurës.

Në kuadër të kësaj korrespondence, nga ASHK Qendrore është kërkuar që të kryhet specifikimi i fushës së përdorimit për secilën prej pasurive, dhe i individualizuar në vendimmarrjen e Këshillit Bashkiak.

Për përmbushjen e kësaj kërkese dhe me qëllim që procedura e transferimit të vijojë me dokumentacion të plotë e të saktë, rezulton e nevojshme ndërhyrja në pikën 1 të VKB-së nr. 151, datë 23.12.2025, duke përcaktuar konkretisht fushën dhe funksionin për të cilin kërkohet transferimi i secilës prej pasurive.

Në përputhje me destinacionin e parashikuar, propozohet që:

- pasuria nr. 441, Zona Kadastrale 1722, të përcaktohet në fushën e shërbimeve publike, me funksion shërbimin funeral;
- pasuritë nr. 395, nr. 409, nr. 432 dhe nr. 430, Zona Kadastrale 1722, të përcaktohen në fushën e zhvillimit ekonomik dhe në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

Është me rëndësi të theksohet se ndryshimi i propozuar nuk ndryshon objektin e vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak dhe as vullnetin e shprehur me VKB-në nr. 151, datë 23.12.2025, për transferimin e këtyre pasurive në pronësi të Bashkisë Sarandë. Gjithashtu, nuk ndryshohen pasuritë objekt transferimi, sipërfaqet apo të dhënat e tyre kadastrale.

Ndryshimi konsiston vetëm në saktësimin dhe individualizimin e fushave të përdorimit, në përputhje me funksionin konkret që do të ushtrohet mbi secilën pasuri dhe me kërkesën e paraqitur nga ASHK Qendrore gjatë shqyrtimit administrativ të praktikës.

Në këtë mënyrë, ndryshimi i pikës 1 synon të sigurojë përputhshmërinë ndërmjet vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak, dokumentacionit teknik dhe administrativ të paraqitur dhe destinacionit konkret të pasurive, duke krijuar kushtet për vijimin dhe përfundimin e procedurës së transferimit të tyre në pronësi të Bashkisë Sarandë.

Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë kërkesën e ardhur si rezultat i korrespondencës së zhvilluar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës – Drejtoria e Përgjithshme, i propozohet Këshillit Bashkiak Sarandë miratimi i projektvendimit "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak Sarandë nr. 151, datë 23.12.2025", duke ndryshuar pikën 1 të tij sipas projektvendimit bashkëlidhur këtij relacioni.

Znj. Pariken Imeraj

Specialist jurist, Drejtoria Juridike

Znj. Garufo Koka

Drejtor, Drejtoria Juridike

Z. Gerald Thoma

Drejtor, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit